



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Raporti teknik

Objekti : Shërbimi I Pastrimit ne Nj.A Velipoje dhe Dajç.

Vendodhja:

Njesia Administrative Velipoje dhe Dajç

Gjendja aktuale.

NjA Velipojë ndodhet 25 km larg qytetit të Shkodrës dhe ka një sipërfaqe prej 72.4 km². Ajo ka nën administrimin e saj 10 fshtra (Pulaj, Velipoje, Reç-Pulaj, Luarzë, Gomsiqe e Re, Baks Rrjoll, Mali Kolaj, Baks i Ri, Reç i Ri, Ças) me një popullsisë prej 9,536 banorësh (5,031 banorë sipas censusit). Pozita e favorshme gjeografike e njësisë administrative Velipojë, e ka kthyer atë në një nga zonat më atraktive për zhvillimin e turizmit detar, lumor dhe malor, të peshkimit dhe të gjuetisë, jo vetëm për bashkinë Shkodër por në gjithë pjesën veriore të Shqipërisë.

Plazhi i Velipojës është një nga zonat më të frekuentuara sidomos gjatë periudhës së verës. Në pjesën veriore të plazhit ndodhet grykëderdhja e lumit Buna ndersa në pjesën jugore të plazhit është laguna e Vilunit, duke i ofruar turistëve peisazhe natyror të vecanta.

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Njësinë Administrative (NjA) Velipojë duhet të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- organizimin ditor të shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve,
- transportit dhe depozitimit final të mbetjeve

Njësia Administrative Dajç ndodhet në jugperëndim të qytetit të Shkodrës, në një distance 22 km larg qendrës së qytetit. Njësia ka një sipërfaqe totale prej 36.5 km² dhe ka nën administrimin e saj 11 fshatrat, Dajç, Samrish i Ri, Samrish i Sipërm, Suka Dajç, Pentar, Belaj, Rrushkull, Shirq, Darragjat, Mali i Gjymtit dhe Mushan me një popullsisë prej 9,083 banorësh (3,885 banorë sipas censusit).

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në NjA Dajç duhet të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- organizimin e grumbullimit të mbetjeve,
- transportit dhe depozitimit final të mbetjeve në landfillin e Bushatit

. Pra ky shërbim, ka përgjithsuar grumbullimin e mbeturinave te banorëve, bizneseve dhe

transportin e tyre drejt landfillit të Bushatit. Ky shërbim do të vazhdojë të kryhet vetëm për këtë proces pune, pra grumbullim-transport-depozitimi mbetjeve urbane.

Objekti

Permisimi i cilesise se shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në NjesiteAdministrative Velipojë dhe Dajç. Rritja e performances në mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurtë të mbetjeve në Landfillin bushat.